

**Njoftim për përqendrim me të cilin PRVA CAP D.O.O Fond Investiv i Specializuar k.d., Slloveni do të fitojë kontroll mbi COOKINOKS Prodhim dhe Shitje të Pajisjeve për Gastronomi D.O.O, Slloveni
(Lënda nr. 08-96/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtje të konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.06.2025, Komisionit për Mbrojtje e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin PRVA CAP D.O.O Fond Investiv i Specializuar k.d., me seli në rr. Fajfarjeva nr. 33, 1000 Lubjana, Republika e Sllovenisë, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë COOKINOKS Prodhim dhe Shitje të Pajisjeve për Gastronomi D.O.O me seli në rr. Stantetova nr. 27, 1295 Ivančna Gorica, Republika e Sllovenisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

PRVA CAP D.O.O Fond Investiv i Specializuar k.d. vepron në tregun e fondeve private investive alternative.

PRVA CAP D.O.O Fond Investiv i Specializuar k.d. menaxhohet dhe përfaqësohet nga PRVA CAP Menaxhim i Investimeve D.O.O – ndërmarrje që merret me menaxhim të fondeve investive alternative. Kontroll të drejtpërdrejtë mbi PRVA CAP Menaxhim i Investimeve D.O.O ushtron PRVA FINANCE D.O.O, me ç ‘rast këto ndërmarrje përbëjnë pjesë të Grupit PRVA CAP.

Në kuadër të Grupit PRVA CAP, PRVA FINANCE D.O.O ka ndërmarrje të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe atë:

- KB Prvo Shoqëri për Menaxhim të Fondeve Pensionale të Detyrueshme dhe Vullnetare SHA Shkup, me seli në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6, Shkup, Qendër, me veprimtari kryesore 66.3000 – Aktivitetet e menaxhimit të fondeve;
- Shoqëri për Sigurim PRVA ZHIVOT SHA Shkup, me seli në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6, Shkup, Qendër, me veprimtari kryesore 65.110 – Sigurim jete.

COOKINOKS Prodhim dhe Shitje të Pajisjeve për Gastronomi D.O.O vepron në tregun e prodhimit të pajisjeve të plota INOX për kuzhina dhe bare, pajisjeve për gastronomi, dizajnit, produkteve metalike dhe pajisjeve. Shoqëria nuk ka shoqëri të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Duke pasur parasysh të ardhurat vjetore totale për vitin 2024 të Grupit PRVA CAP në tregun botëror në shumë prej 30.605.445,00 EUR, dhe të ardhurat në tregun maqedonas në shumë prej 7.549.194,00 EUR, si dhe të ardhurat vjetore të COOKINOKS D.O.O në shumë prej 8.407.882,00 EUR, janë përmbushur kushtet ligjore për dorëzimin e njoftimit për përqendrim. (Të dhënat për të ardhurat të trajtohen si informacione konfidenciale).

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtje të konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim deri te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë deri te Komisioni brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

09.06.2025

Shkup